



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 10.04.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 05.04.2025, të parashtruar nga operatori ekonomik NTSH Dardani, Korbuliq- Kaqanik, Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi i IEA me dru zjarri për periudhën tri vjeqare-Ritenderim”, me Nr. të Prok: 613-24-13138-1-1-1 nxjerr:

V E N D I M

1. Aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim operatori ekonomik NTSH Dardani, Korbuliq- Kaqanik e datës 05.04.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi i IEA me dru zjarri për periudhën tri vjeqare-Ritenderim”, me Nr. të Prok: 613-24-13138-1-1-1 kundër *Vendimit të AK –së*, të datës 02.04.2025 të publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Anulohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë për tenderin me titull : Furnizimi i IEA me dru zjarri për periudhën tri vjeqare-Ritenderim, me Nr. të Prok: 613-24-13138-1-1 dhe lënda kthehet në Rivlersim;

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori ekonomik NTSH Dardani, Korbuliq- Kaqanik më 05.04.2025 ka parashtruar ankesë lidhur me vendimin *për shpërblim me kontratë të datës 02.04.2025* lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi i IEA me dru zjarri për periudhën tri vjeqare-Ritenderim”, me Nr. të Prok: 613-24-13138-1-1-1.

Autoriteti Kontraktues, me datë 10.04.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë, dhe Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Bekim Shabani



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit